



Република Северна Македонија

**Министерство за култура**

- **Sektori për Ndjekjen, Zhvillimin dhe Mbështetjen Logjistike**
- **Departamenti për Çmimet Shtetërore**

Në bazë të nenit 19 paragrafi 1 alineja 1 të Ligjit për çmime shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 52/06, 54/07, 74/12 dhe 99/18) dhe Rregullores për punën e Këshillit për Ndarjen e Çmimit Shtetëror „22 Nëntori“ numër 15-3158/4 nga 03.04.2019, Ministria e Kulturës shpall

**KONKURS**

**PËR PËRPILIMIN E ZGJIDHJES GRAFIKE-FIGURATIVE IDEORE PËR DIPLOMË DHE PLAKETË PËR ÇMIMIN SHETËROR „22 NËNTORI“**

**I. INFORMATAT E PËRGJITHSHME TË KONKURISIT**

1. Furnizuesi i lëndës së Konkursit është Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: furnizuesi).

2. Lënda e Konkursit – Përpilimi i zgjidhjes grafike-figurative ideore për diplomë dhe plaketë për çmimin shtetëror „22 Nëntori“.

3. Përshkrimi i zgjidhjes grafike-figurative: Zgjidhja grafike-figurative duhet t'i pasqyrojë elementet e karakteristikave nacionale, kulturore dhe historike lidhur me alfabetin shqip dhe kjo duhet t'i pasqyrojë angazhimet dhe dedikimet e çmimit shtetëror të përcaktuara në nenin 4-b të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për çmime shtetërore („Gazeta Zyrtare“ numër 99/18), si vijon: **„Me çmimin „22 Nëntori“ u jepet mirënjohje njerëzve nga jeta politike, kulturore dhe shoqërore në Republikën e Maqedonisë të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në avancimin e bashkëjetesës ndërnjerëzore dhe mirëkuptimit të ndërsjellë ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve, kulturave dhe feve të ndryshme në Republikën e Maqedonisë“**. Diploma dhe plaketa shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e tij cirilik dhe në gjuhën shqipe dhe alfabetin e tij latin.

**II. KUSHTET DHE KARAKTERISTIKAT E KONKURISIT**

4. Zgjidhja grafike-figurative ideore për diplomë dhe plaketë për çmimin shtetëror „22 Nëntori“ duhet t'i ketë karakteristikat si vijon:

- për diplomën:

a) t'i përmbajë: „emrin e çmimit, emrin dhe mbiemrin / emrin e ftuesit / fituesve, titullin e realizimit dhe emrin e fushës, veprimtarinë në të cilën është arritur realizimi. Diploma verifikohet me vulë të thatë, me stemën e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Këshilli për Ndarjen e Çmimit Shtetëror „22 Nëntori“ dhe kjo nënshkruhet nga kryetari i Këshillit“;

b) diploma është me dimensione: lartësia 40 cm, gjerësia 28 cm;



Република Северна Македонија

## Министерство за култура

- Сектори për Ndjekjen, Zhvillimin dhe Mbështetjen Logjistike
- Departamenti për Çmimet Shtetërore

- për plaketën:

- a) përmban zgjidhje figurative dhe elementet themelore të tekstit të diplomës;
- b) plaketa është me dimensione 7,5 x 7,5 cm.

Diploma dhe plaketa duhet ta përmbajë motivin e njëjtë figurativ.

- Autorët e zgjidhjeve ideore për diplomë dhe për plaketë të çmimit shtetëror „22 Nëntori“ janë të lirë në të shprehurit e tyre. Zgjidhja grafike-figurative duhet ta pasqyrojë esencën e çmimit shtetëror „22 Nëntori“ dhe përshkrimin e tij të theksuar në pikën 3.

- Zgjidhjet e dërguara ideore duhet të jenë në formë digjitale dhe të shtypur ose lloj tjetër të formës grafike 1:1, me shtojcë të arsyetimit tekstual për konceptin e zgjidhjes grafike ideore.

- Zgjidhja ideore duhet të jetë origjinale dhe e papërdorur deri më tani.

### III. E DREJTA E PJESËMARRJES NË KONKURS

5. Konkursi është publik dhe anonim për pjesëmarrësit. Të drejtën e pjesëmarrjes në Konkurs e kanë të gjithë personat juridikë dhe fizikë.

### IV. MËNYRA E DËRGIMIT DHE AFATI PËR PARASHTRIMIN E MATERIALEVE

6. Punimet e konkursit duhet të dërgohen në mbështjellësin e mbyllur me mbishkrimin Konkursi për përpilimin e zgjidhjes grafike-figurative ideore për diplomë dhe për plaketë për çmimin shtetëror „22 Nëntori“ dhe me rekomandimin e shkruar qartë: „**Mos e hap!**“. Punimi duhet të jetë i shënuar me shifra (maksimum pesë shkronja ose numra) dhe të dërgohet në formë digjitale dhe të shtypur. Të dhënat për autorin duhet të theksohen në zarf të veçantë dhe të mbyllur, të bashkëngjitur me punimin dhe të shënuar me shifrën e njëjtë (adresa për kthimin e punimit, rruga, numri, vendi, qyteti, telefoni për kontakt dhe e-adresa). Punimi duhet të dërgohet në mbështjellës të patejdukshëm dhe të vulosur që është i siguruar nga dëmtimi gjatë transportit.

7. Konkursi zgjat prej 24.5.2019 deri më 24.6.2019, përkatësisht afati i fundit për t'i dërguar punimet në Konkurs është 24 qershor 2019 në orën 16:00 në arkivin e Ministrisë së Kulturës ose me postë në adresën: rruga „Gjuro Gjakoviq“ nr. 61, Shkup. Me dërgimin e punimit të Konkursit në Ministrinë e Kulturës konsiderohet se secili pjesëmarrës i pranon propozicionet e Konkursit.

### V. ÇMIMET DHE BLERJA E KONKURSIT

8. Vlerësimin e punimeve do ta bëjë komisioni i jurisë në bazë të kushteve të Konkursit të cilat dalin nga përpilimi i qëllimeve që janë lëndë e këtij Konkursi:

9. Në Konkurs do të ndahen një çmim dhe një blerje në neto shumat si vijon:



Република Северна Македонија

**Министерство за култура**

- **Sektori për Ndjekjen, Zhvillimin dhe Mbështetjen Logjistike**
  - **Departamenti për Çmimet Shtetërore**

- çmimi \_\_\_\_\_ 40.000,00 denarë;

- blerja \_\_\_\_\_ 20.000,00 denarë.

## VI. NJOFTIMI PËR REZULTATET E KONKURISIT

10. Punimet të cilat nuk i përmbajnë të gjitha elementet e përshkruara në kapitullin **II. KUSHTET DHE KARAKTERISTIKAT E KONKURISIT** dhe në kapitullin **IV. MËNYRA E DËRGIMIT DHE AFATI PËR PARASHTRIMIN E ZGJIDHJEVE IDEORE**, përkatësisht nuk janë të plota dhe janë dërguar jo me kohë, nuk do të jenë lëndë e shqyrtimit në komision. Komisioni i jurisë do ta bëjë vlerësimin dhe do t'i publikojë rezultatet e Konkursit në afat prej 30 ditësh nga dita e përfundimit të Konkursit. Punimet të cilat nuk do të pranohen, do të kthehen në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e përfundimit të procedurës.

11. Ministria e Kulturës do ta blejë punimin i cili do t'i përmbush propozicionet e Konkursit në tërësi dhe do të lidh marrëveshje të autorit për ta shfrytëzuar veprën, përkatësisht për bartjen e të drejtave të autorit që janë të domosdoshme për shfrytëzimin e mëtejshëm të veprës. Blerja, njëkohësisht, do të paraqes edhe kompensim të autorit për të drejtat e lëshuara për të shfrytëzuar veprën, që do të rregullohen me marrëveshje.

## VII. INFORMATAT PLOTËSUESE

12. Për shpjegime plotësuese, të gjithë të interesuarit mund t'i drejtohen nëpunëses së përgjegjshme shtetërore në Ministrinë e Kulturës, Marija Stançevska-Gjorgova, ose në numrin e telefonit 02 3 240 509.